

03.07.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA-SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



01 016 37878

Bazuar në nenin 8 Raportimi para publikut mbi performancën e aksionarëve, pika 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe bazuar në nenin 3 të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Suharekës, me 01-Nr-016/79257, të datës: 22.12.2023, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Stacionin e Autobusëve" SH.A. Suharekë, gjemë të Lokale "Stacioni i Autobusave" SH.A.

Nr. Prot.	01/2024	Nr. 352/25 Dt. 02.07.2025
Për:	Të gjithë anëtarët të Asamblesë të Kuvendit Komunal Suharekë	SUHAREKË
Nga:	Anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve, NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Suharekë Anëtarët: Reshat Selimaj, Kryesuese; Sheqerije Zyrapi; Xhevxhet Gashi Anëtar.	
Lënda:	Raporti i punës dhe aktiviteteve të Komisionit Komunal të Aksionarëve për periudhën prej 01.01.2024 deri me 31.12.2024	

Të nderuar/a

Përmbledhja e punës dhe aktiviteteve të Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Stacionin e Autobusëve" sh.a. në Suharekë për periudhën prej 01.01.2024 deri me 31.12.2024.

Të nderuar/a

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Neni 8, Raportimi para publikut mbi performancën e aksionarëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, "Stacionin e Autobusëve" sh.a në Suharekë pas marrjes së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Suharekës, ka vazhduar punën si organ i zgjedhur sipas Vendimit Nr.01-nr-016/6361 i datë 28/01/2022, duke u angazhuar në dhënjën e kontributit në mbikqyrjen e ecurive të punëve në Ndërmarrje publike "Stacionin e Autobusëve" sh.a në Suharekë. Në takimin e parë të mbajtur me datë 12.01.2024, KKA-së është njofture mbi fillimin e mbar të zhvillimit të transportit gjegjësisht për hyrjet /daljeve e operatorëve transportues të udhëtarëve.

Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kuorumi për mbledhje udhëheqësi i mbledhjes, votat e Aksionarëve dhe kompetencat në mbledhjes janë të rregulluara me akte të veçantë, në pajtim me dispozitat e nenit 138, të Ligjit Nr-02/L-123, për shoqëritë tregtare ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 39/2008), mbledhjen e parë e ka mbajtur me datë :12.01.2024, gjithësej Komisioni Komunal i Aksionerëve ka mbajtur 6 mbledhje për vitin 2024. Gjatë mbledhjeve të mbajtura të KKA-së, është raportuar mbi ecuritë e punëve dhe të hyrave financiare ku u diskutua se një numër i caktuar i operatorëve e sidomos të trasës Pz-Suh-Pr, dhe anasjelltas nuk shfrytëzojnë shërbimet e Stacionit, dhe bëjnë shkelje ligjore duke ndaluar në portëtat (hyrje/daljes), apo në rrugë alternative.

Këta operatorë krijojnë edhe humbje të të hyrave buxhetore për ndërmarrjen, ku nga e cila edhe plani buxhetor nuk është realizuar sipas planifikimit.

- Janë bërë Raportimet e rregullta mujore për punën e Drejtorëve të Bordit të NP Lokale “Stacionin e Autobusëve” sh.a Suharekë;
- Raportimi (Bilanci) financiar rreth të hyrave dhe të dalurave për N.P.L”Stacionin e Autobusëve” sh.a, Suharekë për vitin 2024 të Pasqyres financiare/2024, nga Kryeshefi ekzekutiv(KE), Zyrtari financiar(ZKFTH), e Drejtorët e Bordit(DB);
- Raportit e rregullta financiare për periudhën: tremujore, gjashtëmujore, nëntmujore dhe vjetore të buxhetit, rreth të hyrave dhe të dalurave për N.P.L”Stacionin e Autobusëve” Suharekë për vitin 2024, nga Kryeshefi ekzekutiv(KE), Zyrtari financiar(ZKFTH), e Drejtorët e Bordit(DB);
- Takimi i përbashkët me Kryesuesin e Bordit, Bordin e Drejtorëve, Kryeshefin Ekzekutiv;
- Kemi zhvilluar takime me Bordin e Drejtorëve dhe Stafin Udhëheqës të ndërmarrjës për trajtimin e qështjeve me rëndësi në interes zhvillimor të Ndërmarrjes;
- Gjatë periudhës raportuese, Komisioni ka mbështetur vendimin e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike për hapjen e 5 vendeve të reja të punës, si përpjekje për përmirësimin e shërbimeve dhe zgjerimin e kapaciteteve operationale. Të gjitha pozitat janë shpallur përmesë konkursit publikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me rregulloret e brendshme të ndërmarrjes/Procesi i përzgjedhjes është mbikëqyrur nga Komisioni përkatës dhe është zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente. Nuk është raportuar asnjë ankesë lidhur me procedurën e rekrutimit. Pozita e punës janë; Zyrtare e lartë financiare dhe e thesarit, pozita për Inkasant /Sigurim dhe Mirëmbajtës/Pastrues.
- Kemi dorëzuar dhe njoftuar disa herë Drejtorinë e Inspeksionit në Suharekë, për operatorët të cilët nuk i shfrytëzojnë shërbimet e Stacionit të cilët nuk janë edhe pakë mesatarja ditore e mos shfrytëzimit të shërbimeve tona të peronozimit janë 15 deri 20% operator që nuk hyjnë në stacion por ndalojnë e marrin udhëtar jashtë tek porta hyrës-dalëse, e sidomos këthimi në trasën **Prishtinë-Suharekë-Prizren**;
- Kemi ndërmarr hapat që duhet lidhur me kthimin e lokaleve afariste nën administrimin edhe në emër të ndërmarrjes, duke dergua shkresa e nevojshme në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike dhe Kadastër.
- Kemi dhënë këshilla dhe rekomandime për qështjet me rëndësi të politikave zhvillimore në interes të N.P.L”Stacionin e Autobusëve” Suharekë;
- Jemi njoftuar nga Kryeshefi ekzekutiv e Bordi i Drejtorëve për Planin e Biznesit për vitin **financiar 2024**, për N.P.L”Stacionin e Autobusëve” sh.a. në Suharekë, i cili paraprakisht është miratuar nga B.D. dhe është shqyrtuar dhe miratuar edhe nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.
- Ne si anëtarë të KKA-së jemi angazhuar për çështjen e Licencimit të Ndërmarrjes pasi që ndërmarrja ende nuk ka Licencë, edhe pse të gjitha parakushtet Ligjore janë të plotësuara.

Shenim për ndërmarrjen:

NPL “Stacioni i Autobusave” SH.A zhvillon veprimtarinë vet shërbyese si entitet biznesor bazuar në Ligjin Nr.04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 23 i këtij ligji riformulon listat e NP Qendrore dhe NP lokale dhe përfshinë në listën 2, “Stacionin e Autobusëve” SH.A. me 100% të aksioneve në pronësi të Komunës së Suharekës. Ndërmarrja funksionon si shoqëri aksionare dhe trashëgimtare e NTSH “Kosovatrans” me të gjitha asetet e saja, e cila është regjistruar në ARBK me datë: 21.05.2014 dhe është e pajisur me të gjitha

Çertifikatat e nevojshme për ta ushtruar funksionin e plotë si NPL “Stacioni i Autobusave” SH.A prej datës:01.07.2014 (Çertifikatë biznesi,Çertifikatë me numër fiskal dhe Çertifikatë të tvsh-së). P.S. N.P.L”Stacioni i Autobusave”sh.a. nuk është e licencuarë për ushtrimin e veprimtarisë sipas **Ligjit nr.04/L-179**,dhe Udhëzimit administrativë **Nr.08/2013**,për shkakun se nuk e ka të zgjidhur gjerë me tani çështjen e **Pronës** edhe pse nga organet drejtuese nuk është rreshtur duke trokitur nëpër organe të vendimë marrjes për këtë qështje,pra shkaku i mos licencimit është qështja e pa zgjidhur e pronës(Nga ana e K.Komunalë,gjegjësisht Drejtoria Gjeodezi dhe Kadaster). Stacioni ka të përgatitur infrastrukturen e plotë ligjore (Statutin dhe rregulloret e punës së ndërmarrjes), të cilat janë në harmoni me legjislacionin që i rregullon këto qështje. Edhe pse gjatë kësaj periudhe 2024 na ka përcjellur një situatë jo e mirë,kur kemi parasyshtë se aktiviteti ynë ka koston e shpenzimeve,nuk jemi subvencionuar nga institucionet shtetërore sikur Stacionet tjera regjionale në regjionin e Prizrenit.

- Ne që jemi kontribuesë të rregullt të tatimeve e taksave shtetërore,dhe nuk kemi asnjë obligim ndaj asnjë organi shtetëror.
- Ne jemi ndërmarrje publike por ne punojm/veprojmë vetëm me buxhetin vetanakë i cili plotësohet vetëm nga të hyrat 93,44% Peronizimi dhe Qiraja prej 6.56%.
- Subvencionimi i kësaj ndërmarrje është e merituar e cila deri gjatë këtij viti nuk është subvencionuar,ndoshta është e vetëmja që të paktën deri me tani,nuk ka Obligime ndaj institucioneve Shtetërore,dhe paguan Obligimet e shtetit sipas Ligjeve aktuale!..
- Stacioni ka karakter të interesit të përgjithëshem dhe afatëgjatë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 dhe Ligjit për ndryshim dhe plotësim Nr.04/L-111 mbi ndërmarrjet publike.
- Nga vitit 2002 jemi angazhuar në implementimin e plotë të të gjitha procedurave dhe rregulloreve në pajtim me Ligjin mbi ndërmarrjet shoqërore-publike, dhe objektiv kryesor i strukturës managjeriale ishte rritja e të hyrave respektivisht rritja e arkëtimit,dhe mbajtja e shpenzimeve në kontrollë maksimale që financiarisht të jemi të vetëqëndrueshëm e të kontribojm Buxhetit të shtetit e cila ndoshta është ndërmarrja unike në Kosovën e pas lufte.
- .Nuk kemi obligime ligjore ndaj asnjë institucioni (nuk ka borgje të pa shlyera ndaj askujt),siç janë shpenzimet ndaj komunës (taksat komunale, tatimin në pronë), obligimet nga ATK-së, shpenzimet komunalive (rrymës, ujit dhe mbeturinave),si dhe ndaj operatorëve dhe subjekteve tjera.Pastaj pagesën me kohë të të ardhurave personale të rregullta të punëtorëve në baza mujore.

PUNET E KONTROLLIT (KONTOLLET FINANCIARE)

Përmes raporteve financiare të rregullta,si ato:Mujore;Tremujore;Gjashtëmujore;Nëntmujore dhe Vjetore të krahasuara me ato të vitit paraprak,të cilat shpesh me këshilla KKA e Bordit i Drejtorëve kemi ndikuar që Buxheti të shfrytëzohen sa me racional.

Masa të tjera të sigurisë janë:kontrolli i aparateve të zjarrëfikjesë,kontrollimi i herë pas herëshëm i hapësirave.Kujdesë në kontrollimin e sistemi i kamerave,defektit eventual tyre,dëmtimit eventual të ndonjë kamere,marrja e masa që ato të rregullohen me kohë.

- **Të bashkangjitur e keni edhe Raportin (bilancin) financiar rreth të hyrave dhe të dalurave për NPL “Stacioni i Autobusëve”Sh.A. Suharekë për vitin 2024, si dhe Plan Biznesin për vitin 2025,të përgatitur nga Ndërmarrja.**

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj në këtë raport pune të **Vitit 2024**.



Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusave" SH.A.

Nr. 489/23 Dt. 31.10.2023 I.
SUHAREKË



N.P.L "STACIONI I AUTOBUSAVE" SH.A.
NUI 811033993 ; NR.F 601132111
NR. ____/23 DAT:26.11.2023
SUHAREKË

PËR: Komisionin Komunal të Aksionarëve
TO:

CC: Z. Reshat Selimaj
Kryesues i Komisionit të Aksionarëve
të N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a Suharekë

PËRMES: Z. Qëndrim Gashi
THROUGH: Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a.

NGA: Z. Mr. sc. Halit Elshani
FROM: Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a.

TEMA:
SUBJEKT: **PLANI I BIZNESIT 2024 I N.P.L "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A**

I nderuar Z. Reshat Selimaj

Në këtë dërgesë të bashkangjitur gjeni **Planin e Biznesit 2024** të N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a.

I nderuar,

Menaxhmenti i N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a. ka përgaditur Draft-Panin e Biznesit 2023 brenda afatit të paraparë me LNP dhe po ashtu brenda këtij afati e ka dërguar për shqyrtim në Bord të Drejtorëve ,pas shqyrtimit nga ana e Bordit të Drejtorëve ka miratuar Planin e Biznesit për vitin 2024 të N.P.L "Stacioni i Autobusave" sh.a.

Me respekt.....

PËRMBAJTJA

- I. Prezantimi i biznesit/historia***
- II. Vizioni dhe misioni***
- III. Objektivat e biznesit***
- IV. Analizat financiare***
- V. Pasqyra e të punësuarve(Organogrami)***
- VI. Resurset e nevojshme & Buxheti***
- VII. Qasjet për arritjen e objektivave dhe zbatimi i tyre***
- VIII. Konsumatorët***
- IX. Mekanizmat përcjellës***
- X. Detyrimet karshi konsumatorëve dhe publikut***



N.P.L"STACIONI I AUTOBUSAVE"SH.A –SUHAREKË
NUI 811033993;NR.TVSH 330236853

Plani i biznesit për periudhën 2024

1. Hyrje

Plani i biznesit është një përmbledhje e shkruar e aktivitetit të propozuar dhe parashikuar të kompanisë ku varësisht nga nevoja dhe synimet e kompanisë këto aktivitete të propozuara janë 1(një)vjeqare.Ky plani i biznesit është një dokument i gjallë, evolutiv që shpreh ardhmërinë e kompanisë.Ne si ekspertë vlerësojnë se plani i biznesit është një nga mjetet më të rëndësishme të kompanisë.Plani i biznesit është përgatitur për vetë kompaninë,duke kopjuar strukturën e më poshtme dhe duke zëvendësuar përshkrimet me të dhënat konkrete, të këtij plan të biznesit.

Detajizimi i përmbajtjes së plani të biznesit të ndërmarrjes N.P.L"Stacioni i autobusave"sh.a.

1.1. Pëmbajtja

Plan biznesi përmbanë detaje se si do të zhvillohet biznesi,në periudhën 1(një) vjeçare dhe periudhen se kur do të merren vendimet e veprimit, kush do të marrë pjesë në implementimin e këtij plani dhe si do të menaxhohen paratë. Strategjia e krijimit të planit të biznesit varet se për zhvillimin (rritjen) e biznesit nevojiten financa investime,Gjithashtu gjatë implementimit të tij duhet përqendruar rreth asaj se si do të arrihet me sukses të gjenerohen të hyra dhe kontrolli i shpenzimeve operuese përmes këtij plani.

Konkretisht ky plan i biznesit fillimisht përfshinë një koncept fillestarë dhe të bazuar mbi objektivat,synimet, arsyet e biznesit, pastaj përfshinë një përshkrim të situatës në moment të nismëtarëve të projektit të biznesit ose të situatës në moment të biznesit ekzistues (që tenton drejt zgjerimit).E rëndësishme është se ketu jepen të dhëna mbi grupin menaxhues,për shërbimin i cili do të ofrohet, mbi konsumatorët ose klientët të cilët do të jenë gjenerues të profitit(fitimit), i cili synohet përmes këtij plani.Gjithashtu, duhet analizuar edhe rreziqet që kanosen,nga rrethanat e pa parashikuara,nga analiza jo e sakët e parashikimit.

Përfundimisht ky përshkrim tregon se si pretendohet caktimi i çmimit, si mendohet të realizohet shitja(ofrimi i shërbimit),cilat taktika do të përdoren për të arritur deri tek operatori(konsumatori),detaje mbi shpërndarjen,dhe mënyrën e implementimit të marketingut. Për të qenë i gjithë plani komplet gjithashtu do të sigurojm edhe të dhëna konkrete financiare rrethe gjithë prapa përgatitjes, realizimit të planit si dhe realizimit të profitit nga ofrimi i shërbimeve të caktuar.

1.2. Historiku i shkurtër

Stacioni i autobusave në Suharekë punën e ka filluar si njesi punuese në vitin 1976 në kuadër të Ndërmarrjes për transport të udhëtarve dhe mallrave »Kosovatrans« me seli në Prizren.Karakter i veprimtarisë ka qen shërbyese me të gjitha elementet faktike dhe juridike të cilën edhe sot e kësaj dite e kryen me plotë sukses.

Stacioni i Autobusave në Suharekë ka objektin prej 285m² me lokale percjellëse si salla e udhëtarëve (pritjes), zyra të administratës, sporteleve, restaurantin, nyjet sanitare.

Mbrenda rrethojave stacioni ka pisten (trasën), peronat për kyqjen e operatorve për linjat sipas rendit të udhëtimit në relacione të ndryshme në sipërfaqe prej 2800m², gjithashtu ka një sipërfaqe (lulishte) prej 300m² dhe një sipërfaqe prej 600m² të pa shfrytëzuar mbrapa objektit. Stacioni i Autobusave e ushtron veprimtarin shërbyese në ngastren kadastrale nr.1090/1, Pasuri Shoqrore nga e cila ngaster ju është dhënë sipërfaqja prej 4488 m², sipas Vendimit Nr.351-107 dat:16.11.1976, KK-Suharekë.

2. Përmbledhja ekzekutive

2.1. Prapavija—Prapavija e kompanisë,, Stacioni i autobusave "Sh.a në Suharekë, është: Qendër grumbullimi, distribuimi dhe plotësimi i segmentit të ekonomisë, tregut të shërbimeve në lemin e transportit rrugor të udhëtarëve;

Mirëmban, ofron dhe rregullon qarkullimin e transportit rrugor të udhëtarëve, në linja: **Urban; Ndërrurban dhe Ndërkombëtar**, sipas rendit të udhëtimit, në shërbimë të udhëtarëve (pasaxherëve) dhe operatorëve (transportuesëve).

Menaxhimi (të dhëna mbi firmën)

2.2. Grupi i menaxhimit – Këtu po paraqesim numrin e strukturës menaxheriale dhe strukturën e shtrirjes së këtij menaxhmenti:

- **Komisioni i Aksionerëve 3**
- **Bordi i Drejtorëve i përbër prej 4+1**
- Kryeshefi ekzekutiv
- Udhëheqësi financiar dhe i thesarit
- Udhëheqësi i punëve juridike-sekretari i ndërmarrjes
- Dispeçeri
- Staf i punëtorve-punëtorët drejtëpërdrejt në punë.

2.3. Përgjegjësitë – Përgjegjësitë e menaxhmentit të lartë, janë:

- **Kryeshefi ekzekutiv**
- **Udhëheqësi financiar dhe i thesarit**
- **Udhëheqësi i punëve juridike-sekretari i ndërmarrjes**, të cilët me kontributin e tyre do ndikojnë në ngritjen e cilësisë së punës dhe suksesit afarist, dhe janë përgjegjësit në punë.

2.4. Koncepti - Koncepti i kompanisë konsiston në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore, ndaj operatorve ekonomik dhe pasaxherëve, përmirësim të infrastrukturës dhe stabilitetin financiar afatgjatë dhe të qëndrueshmë.

3. Objektivat—Stacioni i autobusave në Suharekë funksionon në mënyrë normale si veprimtari publike-shërbyese nga shërbimi i peronizimit.

Nga themelimi e gjër me sot Stacioni i Autobusave ka vepruar me afarizem të mirë, dhe pa obligime ligjore, ndaj asnjë institucioni si veprimtari publike shërbyese me interes të veçantë, dhe si objektiv të zhvillimit ka ngritjen e cilësisë së shërbimit ndaj operatorëve dhe pasaxherëve duke iu krijuar kushte më cilësore ambientale, informacione dhe akomodim në pritjen shkuarje-ardhje në linjat e udhëtimit, në relacione të ndryshme.

3.1. Linjat e qarkullimit

- Janë të rexhistruara **143 linja urbane: 57 linja ndërurbane Suh-Pz; 22 linja ndërurbane Suh-Malishevë dhe 82 linja Ndërrurbane (tranzite) Pz-Suh-Prishtinë dhe anasjelltas. Gjithësejt: 304 linja. (Të planifikuara për 2024).**
- I tërë territori i komunës sonë është mbuluar me qarkullimin transportit rrugorë të udhëtarëve ku pikënisjen dhe këthimin e kanë nga Stacioni.

- Nga Stacioni Ardhja-Këthimi mbrenda 24 orëve transportohen në të gjitha drejtimet sille të rrethë **6200-7100** Udhëtar(Pasaxher)të të gjitha kategorive,si punëtor të profileve të ndryshme:të arsimit,administratës,student,nxënës të shkollave së mesme dhe fillore etj.

3.2. Menaxhimi - Përshkrimi i menaxhimit të këtij projekt të ri,është vendosja e objektivit,misionit dhe pikat e suksesit(pikat e suksesit nënkupton ato elemente si të domosdoshme për arritjen e suksesit dhe këto pika janë:

- Ofrimi i shërbimeve për operatorët e transportit në komunikacionin rrugor të udhëtarve.
- Pranimi dhe percjellja e udhëtarve në të gjitha linjat
- Percjellja e levizjes së autobusave sipas rendit të udhëtimit
- Mbajtja e evidencë dhe raportit sipas rendit të udhëtimit
- Informimi i udhëtarve mbi ardhjen-nisjen e operatorve.
- Mbikqyrja dhe kontrolli i transportit sipas rendit të udhëtimit i cila ndikon në ngritjen e efikasitetit dhe të përgjegjësis të operatorët.
- Stacioni ka potencial,infrastruktur dhe lokacion të ndërtuar me të gjitha objektet për shërbimin e udhëtarve-operatorve në kushte normale.
- Pranimi dhe percjellja e udhëtarve në linja urbane;ndërrurbane dhe ndërkombëtare.
- Akomodimi i udhëtarve(pasaxherëve) dhe siguria e tyre
- Eliminimi i ngarkesave në trafik në shumë pika të shpërndarjes dhe marrjen së udhëtarve vendë e pa vendë
- Është nyje(pikë-lokacion) kyqë për qarkullimin e transportit rrugorë të udhëtarve,sepse transport tjetër të organizuar të udhëtimit nuk ka.
- Pranimi dhe percjellja e udhëtarve në linja urbane;ndërrurbane dhe ndërkombëtare.
- Dhënja e mundësisë udhëtarit dhe operatorit për informim real,të saktë,të shpejtë dhe precizë,të cilët nuk do të kenë humbje në kohë dhe pritje të panevojshme.

3.3. Plani Financiar-Pikat kyqe të planit financiar,si baza themelore janë:**Të hyrat nga shërbimet e Peronizimit dhe Qiraja.**

4. Pozita financiare e Stacionit të Autobusave në Suharekë

- Pregaditja e planifikimit Buxhetor 2024 edhe këtë herë jemi në pozit të vështirësi të një planifikimit të parashikuar sa më real që nga datë: 14.03.2020 kur edhe filloj situata e rënduar e pandemisë Covid 19 e cila situat edhe na pamundëson të planifikojm arritjen e caceve të parashikuara nga arsyeja se nga aktiviteti afarist në rrethanat e pandemisë Covid 19 deri me tani jemi në pozit të vështirë(jo normale)me planifikimin e parashikuar të vitit 2024 për shkak të rrethanave të krijuara nga Pandemia globale Covid 19.
- Kjo situat ka ndikuar që hyrat buxhetore të devijoj për të mirë nga Planifikimi i vitit 2023 deri në TM3/2023,(Nëntëmujor/2023)të realizuar prej **104,639.88€** Bruto,të krahasuar nga e njëjta periudhë TM3/2022 prej **98,394.82€**,që do të thotë se në këtë Nëntëmujor/2023 kemi pasur rritje në shumën prej **6,245.06€**.shprehur në %(përqindje) **6.80%** nga Peronizimi.
- Të hyrat e planifikuara(parashikuara)për vitin pasues 2024,sipas Raportit Nëntëmujor të vitit 2023 dhe Plani financiar të realizuar 2023,të hyrat e pritura (planifikuara) për vitin 2024 do të jenë.
- Të hyrat e planifikuara nga peronizimi dhe qiraja:

Peronizimi: -----134,571.50€

Qiraja: -----8,867.76€

Totali :-----143,439.26€

- Planifikimi për 2024 nënkupton të hyrat duke përfshirë edhe tvsh 18%, të shprehur në % (përqindje), parashikojmë një rritje të vogël ndaj vitit 2023 prej 8%.
- Realizimi i arritur në vitin 2023 (të hyrat nga peronizimi dhe qiraja, në Nëntmujorin TM3/23 ishte **104,639.88€** (bruto e hyra) në TM3/2022 (Nëntmujorin e tretë) ishin **98,394.82 €**.
- Kjo rritje e lehtë prej **0.8%** do të bëhet duke pasur parasysh ngritjen e cilësisë së shfrytëzimit të shërbimeve në Stacion (hyrje-daljet) nga operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve në linja të rregullta operuese dhe mbështetjen e institucioneve relevante sipas Ligjit, nga Ministria e Infrastrukturës e Inspektorit të Komunikacionit rrugor e të Inspektorit të Komunal të Komunikacionit rrugor të udhëtarëve.
- Gjatë vitit 2023 (TM3/23), të hyrave e planifikuara nga peronizimi janë realizuar mbi planifikimin, ku nga fillimi i vitit aktual 2023 një numër i caktuar i operatorëve ekonomik kanë filluar shfrytëzuar shërbimet tona, por disa edhe e kanë ndërprerë aktivitetin e veprimtarisë në mungesë të leverdisë ekonomike dhe humbjeve nga mungesa (kufizimi) i lëvizjes së pasaxherëve në transportin rrugor në Trasën **Suh-Pz**, si Operatorët transportues: Gimi; Loni; Beni; Teuta market; Fati e disa edhe ditëve të shtuna nuk mbajnë linjat sipas Rendit të udhëtimit që janë pajisur nga Ministria gjegjësisht Departamenti i kësaj ministrie!..
- Nga Janar/2023 e TM/3 2023, operatori ekonomik nuk kanë shfrytëzuar shërbimet e Stacionit, në veçanti Linja e këthimit (**Pr-Suh-Pz**), operatorët kanë operuar dhe kanë zbritur e marrur udhëtar tek portat e **Hyrjes-Daljes**, por edhe kanë levizur në trasën e **Rrugës "Hajdin Berisha"** prapa Stacionit të autobusave duke ndaluar e zbritur udhëtar në vende jo të destinuara sipas Ligjit dhe duke krijuar edhe pengesa (probleme) për qarkullim të qytetarëve dhe automjeteve tjera në oraret e tyre të lëvizjes, gjithashtu edhe gjatë ditëve të shtuna e të diela një pjesë e operatorëve në Linjat **Pz-Suh-Pr** dhe **anasjelltas** nuk shfrytëzojnë shërbimet tona, e në veçanti **anasjelltas (Pr-Suh-Pz)**, nuk kanë shfrytëzuar shërbimet e stacionit, por zbresin dhe marrin udhëtar (pasagjer) jashtë stacionit dhe është pamundësuar realizimi i gjerëtanishëm i Planit financiar të parashikuar.
- Bruto të hyrat vjetore në N.P.L "Stacionin e autobusave" sh.a. janë parashikuar të sillen për vitin 2024 Bruto rrethë **143,439.26€**, por që realisht në TM3/2023 janë realizuar vetëm **104,639.88 €** (bruto të hyra nga Peronizimi e Qiraja).
- Edhe pse kemi planifikuar (parashikuar) një rritje të lehtë prej **0.10%** (krahasuar nga vitit 2021 që ishte parapa (0.18%), e që deri në periudhën TM3 (Nëntmujore) 2022 nuk është arritur pasi që në muajt në vazhdimësi ka pasur mungesa të operatorëve që shfrytëzojnë shërbimet tona për **Marrjen- Zbritjen** e udhëtarëve, por edhe ndërprerje të veprimtarisë në mungesë të pasagjerëve.
- P.S. Edhe pse NPL "Stacioni i autobusave" sh.a. ka qenë i hapur (ka zhvilluar aktivitet ekonomik), Operatorët ekonomik të transportit rrugorë të udhëtimit nuk kanë shfrytëzuar shërbimet tona sipas Ligjit (Ligji Nr.04/L-179) me të cilin janë të rregulluara edhe çështjet e sektori të ekonomisë së vendit, sepse jo vetëm që është dëmtuar buxheti i Ndërmarrjes por edhe ai Shtetëror, sepse ne nga shërbimi i mbledhur paguajmë TVSH (Tatimin në vlerën e shtuar) e tatimet tjera Arkës shtetëror, sikur që Ne jemi kontribues të rregullt

- **Të Tatimeve e taksave shtetërore.**
 - **Ne jemi ndërmarrje publike por ne punojmë dhe kemi buxhetin vetanakë i cili plotësohet vetëm nga të hyrat Peronizimi(93.82%),dhe Qiraja rrethë (6.18%).**
 - **Ndërmarrje NPL"Stacioni i autobusave"sh.a.ndoshta është e vetëmja që të paktën deri me tani nuk ka obligime ndaj institucioneve Shtetërore,dhe i paguajn Obligimet e shtetit sipas Ligjeve aktuale!..**
 - **Ndërmarrja nuk ka asnjë obligim ligjor gjatë operimit ekonomik/financiar institucioneve shtetërore siqë janë:KK-Suharekë(taksat komunale;Tatimi në pronë;Administratës tatimore;Komunalive si:Ujit;Mbeturinave;Energjia elektrike;PTK-së etj.Për të gjitha kemi dëshmi dhe argumente se jemi azhur në kryerjen e obligimeve të përcaktuara ligjore.**
- 5. Udhëheqja-Struktura menagjeriale dhe udhëheqëse e N.P.L"Stacionit të autobusave"sh.a. mbikqyret dhe udhëhiqet nga:**
- a/.Komisioni i Aksionerëve,është Organi më i lartë që mbikqyr punën e ndërmarrjes përmes mekanizmave të zgjedhur për funksionim sa më të mirë dhe angazhohet me kontributin e tij me takime 1(Një) herë në 2(dy)muajëve,apo 6(Gjashtë) takime vjetore të rregullta.**
- b/.Bordi i Drejtorëve** si organ më i lartë pas Komisionit të Aksionerëve,mban takime të rregullta **2(dy)** herë në muajë apo 24 takime vjetore dhe sipas nevojës Drejtoret e Bordit vizitojn herë pas here dhe në mënyrë rigoroze punën e **Kryeshefit Ekzekutiv** dhe **2(dy) Zyrtarëve të lartë.**
- Kontributi i Bordit të Drejtorëve në këtë planifikim buxhetor pa dyshim është i konsiderueshëm me vërejtje dhe sygjerime.Veprimtaria shërbyese në lëmin e transportit rrugor të udhëtarëve ka karakteristika e veta sepse levizja e pasaxherëve dhe operatorëve ekonomik është ofertë jo konstante(fikse),por relative e cila kërkon një përkushtim dhe qasje specifike në mënyrë që parashikimi të jetë sa më i drejtë.
- 6. Burimet financiare – Ndërmarrja ka burimet vetanake financiare,nga sherbimi i peronizimit dhe qiraja,nga këto të ardhura mbulohen të gjitha shpenzimet operative.**

6.1 Tabela e të Hyrave financiare 2022

BURIMET FINANCIARE	2022
PERONIZIMI	123,946.50 €
QIRAJA	8,867.76 €
TË HYRAT TJERA AFARISTE	0.00 €
TOTAL:	132,814.26€

P.S.Vlerat janë llogaritur me TVSH(Tatimin në vlerën e shtuarë).

Planifikimi për vitit 2023 fatkeqësisht do të ketë një rënje nga sherbimi i peronizimit(Hyrja),duke llogaritur se do të vazhdoj edhe më tutje situata jo e mirë,të paktën që shifetnë Periudhën e TM3/2023.

Operatorëve ekonomik të transportit rrugor të udhëtarëve, janë të obliguar sipas **Ligjit për komunikacionin rrugor të udhëtarëve(Ligji Nr.04/L-179)**,për shfrytëzimin e shërbimeve të Stacioneve,ku shpresojmë do të respektohet dhe sidomos këthimin në Linjen e kthimit

Pr-Suh-Pz, që rrethë **19%** e tyre nuk kanë hyrë në Stacion dhe angazhimet e institucioneve përkatëse nga periudhën 14.03.2020 dhe ende deri me tani nuk kanë vepruar permanent nga ana e Inspektoriatit në mënyrë që **O.E** të veprojnë konform Ligjit për komunikacionin rrugor të udhëtarëve (**Ligji Nr.04/L-179**), ne parashikojmë që do të eliminohet kjo dukuri atëhere edhe do të kemi ngritje të të hyrave sepse në këtë rast dëmtohet edhe Buxheti vetanak i Ndërmarrjës por edhe Buxheti i shtetit prej **18% të tvsh**.
Ndërsa qiraja do të jetë e planifikuar sikur në vitin 2022, (mujore) për shfrytëzuesit e qirasë.

6.2. Tabela burimeve financiare e të Hyrave Janar-Shtator/2023

BURIMET FINANCIARE	2023
PERONIZIMI	97,989.06€
QIRAJA	6,650.82€
TOTAL:	104,639.88€


P.S. Vlerat janë llogaritur me Tvsh (Tatimin në vlerën e shtuarë). Vlenë të theksohet se nga viti paraprak (2022) kemi Parashikuar një rritje e të hyrave prej 0.10%

6.3. Tabela e burimeve financiare të planifikuar (parashikuar) për vitin 2024

BURIMET FINANCIARE	PLANIFIKUAR 2024	Pjesmarrja në % (përqindje)
PERONIZIMI	134,571.50€	93.82 %
QIRAJA	8,867.76€	6.18 %
TOTAL:	143,439.26€	100 %

P.S. Vlerat janë llogaritur me Tvsh (Tatimin në vlerën e shtuarë me 18%).


6.4. Tabela e burimeve financiare të planifikuar (parashikuar) për vitin 2023



Bruto e hyra e planifikuara prej **143,439.26 €**, (do të sillën prej një rritje të planifikuar 8%) të cilat do të alokohen dhe destinohen për shpenzime operative sipas kategorive ekonomike, shp. operative të ndërmarrjës.

Paga dhe meditje	96,200.00€
Riparime dhe mirëmbajtja	9,800.00€
Mallra dhe sherbime	6,200.00€
Shpenzime komunale(energji elektrike; uji dhe mbeturinat)	4,700.00€
Kemikate derivate	3,900.00€
Shpenzime operative Total	120,800.00€

6.5. Tabela e shpenzimeve operative gjatë vitit 2024 dhe përqindja e pjesmarrjes në Fitimin bruto vjetorë



6.6. Tabela e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2024

Nr.	Kategorit ekonomike	Pjesmarrja në shpenzime	Pjesmarrja në % (përqindje)
1	Paga, meditje	96,200.00€	79.64%
2	Mirëmbajtje dhe riparimet	9,800.00€	8.11%
3	Mallra dhe sherbime	6,200.00€	5.13%
4	Shpenzime komunale	4,700.00€	3.89%
5	Kemikate (pastrim-higjienike) derivate	3,900.00€	3.23%
	TOTAL	120,800.00€	100%

- **Kategoria ekonomike, Paga, medijë**, janë planifikuar pagat e Komisionit të Aksionerëve; Bordit të Drejtorëve; Pagat e punëtorëve sipas vendëve (pozitive) të punës.
- **Kategoria ekonomike, Mirëmbajtje dhe riparimet** të planifikuara janë parapa, Mirëmbajtja e riparimet në asete, trasë e objekte, me qëllim që të kemi ambient sa më kualitativë.
- **Kategoria ekonomike, Mallra dhe shërbime** janë planifikuar shpenzime operative si paisjet dhe inventar; material hargjuesë për zyre, të nevojshëm për funksionim sa më të mirë të punëve në administratë.
- **Kategoria ekonomike, Shpenzime të komunalive**, janë planifikuar shpenzime operative për energji elektrike, uji e mbeturinat.
- **Kategoria ekonomike, Kemikate dhe derivate**, janë planifikuar shpenzimet operative për përdorimin e mjeteve kimike higjieniko-sanitare të pastrimit dhe dezinfektimit të nyjeve sanitare dhe zyrave të administratës dhe në përgjithësi objekteve, gjithëashtu edhe derivatet për nevoja të gjeneratorit sipas nevojave.

7.1. Çmimi dhe fitimi - Sipas analizës çmimet e shërbimit (peronizimi) dhe fitimet do të realizohen duke ngritur cilësinë e shfrytëzimit të peronit nga **Operatorët e transportit tokësor** të udhëtarëve (hyrjen-daljen), të cilat vërtetohen me fakte (dëshmi) të raporteve paraprake ditore. Struktura bazë e metodës së përpilimit të çmimeve e të tarifës së peronizimit dhe qirasë është e bazuarë në përlllogaritjen e angazhimeve shërbyese dhe shpenzimeve tjera që ndërlidhen me aktivitetin operativ të cilat kanë pjesmarrje në koston e çmimit. Çmimet e peronizimit që nga viti 2002 kanë qenë të harmonizuara edhe me Departamentin e Komunikacionit rrugorë të udhëtarëve, dhe gjerë me tani nuk janë ndryshuar, dhe do të jenë në fuqi në planifikim edhe për vitin 2024.

6.7. Tabela e çmimit (tarifa) e shërbimit të peronizimit

Nr.rend.	Trasa e transportit tokësor të udhëtimit	Çmimi i peronizimit
1	Urbane	1.50 €
2	Ndërrurban (Suh – Pz, dhe anasjelltas)	2.00 €
3	Ndërrurbane (Pz – Suh – Pr, dhe anasjelltas)	2.00 €
4	Ndërkombëtare	3.50 €

7.2. Objektivat primare të firmës – Stacioni ka karakter të interesit të përgjithshëm dhe afatëgjatë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 dhe Ligjit për ndryshim dhe plotësim Nr.04/L-111 mbi ndërmarrjet publike. Gjatë vitit 2024 do të angazhohemi në implementimin e plotë të të gjitha procedurave dhe rregulloreve në pajtim me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, për ndryshim dhe plotësimin e këtij Ligji. Dhe objektivi kryesor i strukturës Managjeriale për vitin 2024 është rritja e të hyrave respektivisht rritja e arkëtimit, dhe mbajtja e shpenzimeve tjera nën kontroll maksimale që financiarisht të jemi të vetëqëndrueshëm.

Menaxhmenti do të harmonizon fuqinë punëtore, kapitalin real teknik informacionin dhe diturin për të bërë shërbime përkatëse drejtë krijimit të afarizmit sa më pozitiv dhe rentabil.

Ky planëprogram zhvillimor ka të bëjë me synimet e N.P.L., "Stacioni i autobusave" sh.a. në Therandë në zhvillimin, realizimin e punës konkrete e cila do të rezultojë me profitabilitet dhe prespektiv të shëndosh, objektive duke e mbrojtur substancën dhe pasurin gjegjësisht rritjen e saj me afarizem të mirë dhe stabil.


Pra,berja e asaj qe aeshirojme me ate qe disponojm;ose arejtepesnimi i objektivave me resurse disponuese

11.

7.3. Sistematizimi i vendeve të punës:

Sistematizimi i pozitave(vendeve të punës)pas një analize,Bordi i Drejtorve gjatë muajve **Maj - Qershor /2014**,ka saktësuar Organogramin e të punësuarve,duke u mbështetur në legjislacionin e Ndërmarrjes dhe duke vlersuar përgjegjësit dhe detyrat e vendeve të punës,sipas Ligjit,Statutit dhe Rregulloreve për secilin vendë pune ka përcaktuar sistematizimin e të punësuarëve e cila do të jet e planifikuar edhe për vitin 2024. Më posht paraqiten bartësit dhe përgjegjësit organizativ dhe strukturen e pozitave të të punësuarëve.

Organogramin në N.P.L,,Stacioni i autobusave“sh.a



7.4. Planëprogrami zhvillimor i punës afatëshkurt(një vjeqare).

Do të ndërmerret masa në rritjen dhe nxitjen e azhuritetit ,efikasitetit,respektimin e orarit të punës,inkasimine e taksës së peronizimit si të atij Urban(lokalë),dhe atij Ndërrurban(tranzit).

Monitorimin permanent të hyrjes dhe daljes se autobusave të kompanive transportuese,me kamer.

Intervenimin dhe bashkpunimin me inspektotrin e komunikacionit rrugor;me SHPK-në; Departamentin e komunikacionit rrugor të udhtarëve pran Ministrisë se Infrastrukturës dhe me të gjitha institucionet relevante tjera.

-Menaxhim profitabil dhe të qendrueshem financiar.

-Respektimin e Statutit dhe akteve tjera normative(Rregullorëve)të ndërmarrjes të cilat burojnë nga Ligji.

-Vënjen në veprim në çdo kohë të laurave(mbyllëseve)në hyrje dhe dalje të stacionit e cila do të ndikoj në sigurin dhe mbarëvajtjen e punëve.

-Respektimin e linjave(vijave) për operator(auto-transportues)të të gjitha niveleve(Urban;Ndërrurban dhe Ndërkombëtar).

-Sigurimin e kushteve higjenike-sanitare mborenaa ne stacion ane teras,ne menyre qe udhetaret(pasaxhere)te i behet pritje ne kushte sa me te mira higjenike e funksional.

12.

- Sigurimin me kohë të TAP(të ardhurave personale-Rrogave),për punëtor.
- Percjellja e trenave afariste të ndërmarrjes.
- Vendosja e itinerarit (tabelen e Linjave/vijave) në vendin të pashem dhe të lexueshem në mënyrë që udhetarët mos të kenë huti në drejtimet e dëshiruara.
- Vendosjen e ulsëve në terasë dhe në sallën mbrenda stacionit për udhetar.

- Percjelljen e raportit të rrjedhjes së paras (KESH-it)(hyrjet dhe daljet).
- Hartimi i raporteve financiare dhe raportimi i planit financiar
- Kontabilizimi i të gjitha transaksioneve financiare sipas standardeve të kontabilitetit.
- Hulumtimi dhe pregaditja e projekteve për zgjerimin e kapaciteteve punuese-sherbyese.
- Pregaditjen e Raporteve(Bilancit) 3(muor);Pasqyrimi i të ardhurave:(e ardhura,shpenzimi dhe fitimi për periudhën në fjalë:Përqindja e Neto fitimi e të hyrat nga sherbimi i peronizimit.

Në këtë periudhë rolë të rëndësishëm do ti kushtohet planit të rrjedhjes së parasë(qarkullimit të parasë),pra hyrjes dhe daljes së parasë në periudhë(ditore;muore dhe vjetore).

Ky raport financiar për ekonomin e tregut është më i rëndësishmi që mvarsishtë nga kapitali punues shofim afarizëm pozitiv apo negativ në këtë Biznesë.

Pra parat në fillim të periudhës dhe të gjitha parat që mblihdhën (keshi) nga sherbimet(shitjet),pra totali i parasë se hyrë,dhe zbritja e parave të dalat (të gjitha shpenzimet Operacionale) në mënyrë që mbetja të jetë pozitive :

Hyrja > se dalja = Rezulltati pozitivë.

8. Nga Fitim,Shpenzimet operative sipas planifikimit do të ndahën:

8.1.Shpenzimet operative sipas planifikimit në një buxhet vetanak është i vështir për tu realizuar pasi që kërkesat janë më të mëdha në investime kapitale e që Buxheti vetanak është i vogël për kërkesat investive të objektit të stërvjetruar nga 1976,e si pasoj shpenzimet në emër të pagave dhe meditjeve e shpenëzon këtë Buxhet vetanak rreth 80 % të tij.

- 79.64 % e shpenzimeve operative ,do të shfrytëzohen për Paga dhe Meditje
- 8.11 % e shpenzimeve operative ,do të shfrytëzohen për Riparimet dhe Mirëmbajtje e investime,e që në fakt janë pak pasi që Buxheti vetanak na pa mundëson që mbulimin e nevojave për të i mbuluar këtë Kategori ekonomike e domosdoshme pasi që objektet e Stacionit janë shumë të vjetruara dhe kërkohet shumë mjete Investive.
- Do të ndjekim politik afariste likuide për të përballuar obligimet financiare(shp.operative) mbrenda periudhës se caktuar kohore dhe realizimin e suksesshem të punëve.

8.2. Menaxhimin e konflikteve dhe kontesteve që kanë të bëjnë me fushëveprimtarin e ndërmarrjes sonë.

-Në mesë puntorëve,Kompanive transportue dhe personave tjerë.Si përmes;negocimit kompromiseve dhe objektivizmit të drejtë në arritjen e qellimeve të mira,rezultateve,simpative dhe respektit të ndërsjelltë.

-Në konteste dhe konfliktetë cilat kerkojnë një qasje dhe angazhim më të madhë dhe të cilat janë më të ndertlikuara do të kerkojmë edhe ndihmën nga institucionet relevante dhe përvojat institucionale.

-Shfrytëzimin e masmediave të shkruara dhe elektronike për propagandim dhe reklamim të rezultatenë lidhje me punën gjithënjë duke e ruajtur sekretin dhe kredibilitetin e ndërmarrjes,sigurim të vazhdueshem të rrjetit informuës permes web-faqës për qasje dhe informim(www.stacioniautobusave-suh.com).

-Kontakte me kompani transportuese ne lidhje me shërbime sa ma cilësore per uanetar ne nivel të komunës sonë.

13.

-Kryerjen e të gjitha obligimeve ndaj administratës së shtetit,dhe të tjera.

8.3. Në planin e investimeve afatëshkurta do të kemi qasje në:

- Mirëmbajtja e platos (terasës) nga kushtet atmosferike.
- Mirëmbajtja e tërësishme(rrethinës) e sipërfaqës së stacionit.
- Mirëmbajtjen e nyjeve sanitare(wc),që e shfrytëzon një komunitet i gjër jo vetë Pasaxherët por edhe shumë biznese që thethojnë stacionin.
- Mirëmbajtjen(lyerjen) e objektit dhe aftësimi për punë të lokaleve të mbrendëshme (zyrave),të cilat duhet mirëmbajtur për shkak të amortizimit dhe vjetërsisë.

9. Plani afatëshkurtë 1 (vjeqarë)

Me qellim që vizioni dhe objektivat e zhvillimit të ndërmarrjes të jenë profitabile do të zhvillohen aktivitete fitimprurëse dhe ruajtjen e stabilitetit gjegjësishtë zgjedhjen e mënyrave për maksimizimin e fitimit si shfrytzimi i aktiviteteve,këmbinimi:

- Nga eksperiencia dhe preferenca e bizneseve.
- Investimeve fikse.
- Krahasimi i treguësve (buxheteve në investime).

Hapë shumë i rëndësishëm i këtij plani është përfshirja e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës të cila janë shprehur në buxhetin vetanak të firmës.

9.1. Në këtë periudhë planifikojmë realizimin e këtyre objektivave:

- Mirëmbajtja e rrethojës mbrojtës nga rruga kryesore „Brigada 123”,dhe tërësisht rrethojave të sipërfaqës ku zhvillohet veprimtaria e ndërmarrjes,në mënyrë që të krijohet siguri më e madhe për udhëtar.
- Mirëmbajtja dhe Rregullimin i WC(nyjeve sanitare)mbrapa objektit të ndërmarrjes të cilat do të krijojn kushte më të mira higjenike dhe sanitare për nëvojtar.

9.2. Synimet e biznesit

- Ruajtjen e pasurisë dhe mjeteve themelore.
- Krijimin e vendeve të lira të punës – sipas vëllimit të punëve dhe mundësive.
- Rritja e përgjegjësisë në punë,nga niveli lart-poshtë

Vitet 2023(TM3/23,pra Nëntmujori 2023),i të hyrave të planifikuara nga peronizimi është realizuar mbi pritëshmerit e planit 2023,për shkakun se O.E-transportues i kanë shfrytëzuar shërbimet tona,të cilët kanë respektuar Ligjit për komunikacionin rrugor të udhëtarëve(Ligji Nr.04/L-179) për Marrjen – Zbritjen e udhëtarëve,për këtë arsye kemi mundur që të arrim objektivin tonë financiar mbi planin financiar.

O.Ekonomik nga muajt Janar-Shtator/2023,e gjërë me tani në relacionin **Pz-Suh-Pr**,dhe në veqanti anasjellta **Pr-Suh-Pz** nuk i kanë shfrytëzuar shërbimet e stacionit kohë pasë kohe por kanë Zbritur dhe Marrur udhëtar(pasagjer)jashtë stacionit dhe është pamundësuar realizimi i gjerëtanishëm i planit të parashikuar 2023.

- Gjatë periudhës Nëntëmujore TM3/2023,janë disa nga shkaqet të cilat kohë pas kohe edhe janë diskutuar në mbledhje të Bordit për mos realizimin e Plani të parashikuar për 2023,e që janë disa nga trasat-linjat e operatorëve si:

-Operatorët e linjave urbane gjatë pushimeve verore të shkollave nuk i mbajnë disa nga linjat sipas rendit të udhëtimit.

-Operatorët e transportit të udhëtarëve në linja ndërurbane **Pz-Suh-Pr** dhe anasjelltas nuk shfrytëzojnë trasën e stacionit **Pr-Suh-Pz**,pas dite,të Shtunave e ditëve të diela nuk hyejën fare.

-Disa nga operatorët e transportit të uanetareve në linja ndërrurbane Suh-RZ, atëherë të shtuna e të dielave nuk punojnë fare.

14.

-Operatorët e transportit të udhëtarëve në linja ndërrurbane Suh-Malishevë nuk i mbajnë linjat kohë pas kohe, sidomos gjatë ditëve të verës (Qershor; Korrik; Gusht).

-Edhe pse disa nga shkaqet e theksuara për planifikimin buxhetor për vitin 2023, janë të shkruara, këto janë disa nga shkaqet që parashikimi i mundshëm për mos realizimin e synuar të këtij plani.

10. Objektivat financiare

10.1. Kërkim dhe zhvillim – sektori për kërkim dhe zhvillim është përgjegjësi e Kryeshefit ekzekutiv; Udhëheqësi financiar dhe të thesarit, dhe Udhëheqësit të punëve juridike-sekretari-e.

10.2. Mbështetje nga jashtë - Do të kërkojmë të keni mbështetje profesionale, nga niveli lokal si dhe atij qendror, ose bashkëpunime me të tjerët, për lëmi të ndryshme nga fusha e veprimtarive shërbyese (transportit të udhëtarëve).

10.3. Përkrahimi i shërbimit (produktit)

Veprimtaria momentale, është shërbyese, shërbimi (peronizimi) me 93.82% dhe 6.18% nga qiramarrja e cila participon në bruto të hyrat buxhetore të ndërmarrjes.

10.4. Teknologjia gjegjëse – është ofrimi i shërbimit të peronizimit operatorëve të transportit tokësor të udhëtimit.

10.5. Qëllim i dobishëmerisë dhe të mirave, për pasaxher dhe operator

- Akomodimi i udhëtarëve (pasaxherëve) dhe siguria e tyre
- Dhënja e mundësisë udhëtarit dhe operatorit për informim real, të saktë, të shpejtë dhe precizë, të cilët nuk do të kenë humbje në kohë dhe pritje të panevojshme.
- Pranimi dhe përcjellja e operatorëve, në linja urbane, ndërrurbane dhe ndërkombëtare.

10.6. Cikli jetësorë – Cikli i jetës së shërbimit dhe veprimtarisë shërbyese është i pa kontestueshë dhe afatgjatë në të cilin implikime do të ketë edhe shumë faktor tjerë relevant

10.7. Infrastruktura - Infrastruktura rrugore në KK-Suharekë është e ndërtuar mjaftë nga qendra komunale në drejtime urbane deri në vendbanimet edhe më të thella malore ku edhe ka mundësuar zhvillimin e transportit tokësor të udhëtarëve.

- Nga Suharekë janë të asfaltuara të gjitha rrugët të cilat janë arterjet kryesore ku zhvillohet qarkullimi i komunikacionit rrugorë si:
 - Rruga: Suharekë-Rahovecë.
 - Rruga: Suharekë-Mamushë.
 - Rruga: Suharekë-Nishorë (Breshancë-Pagarushë-Dragobil).
 - Rruga: Suharekë-Leshan-Tërrnje-Nepërbisht.
 - Rruga: Suharekë-Reçan-Budakovë-Papaz.
 - Rruga: Suharekë-Grejkocë.
 - Rruga: Suharekë-Mushtisht-Dellocë e Maqitevë.
 - Rruga: Suharekë-Vranë etj.

Suhareka është e lidhur me të gjitha lokalitetet urbane (fshatëra), me rrugë të asfaltuara, me rreth 195 km, dhe të gjerësisë mesatare rreth 5.00 m.

11. Lista e Operatorëve (konsumatorëve) – Lista e operatorëve (konsumatorëve) që Stacioni i autobusave i u ofron shërbime janë: Urban; Ndërrurban dhe Ndërkombëtar si më poshtë:

Konsumatorët – Operatorët transportit tokësor të udhëtarëve, të linjave urbane, ndërrurbane dhe ata ndërkombëtare, si dhe ato sezonale të turizmit, piknikut, eskursionet.

1.1. Urban: Linja Suharekë – vendëbanime(fshatëra)

Emri i kompanisë-Operatorit	Vendi	Transporti me autobusë
DIANA	BUDAKOVË	Po
VRANIQI TRANS	VRANIQ	Po
MELI	MUSHTISHT	Po
XHATI	GJINOCË	Po
SHARRI	GREJKOC	Po
GASHI	GELANCË	Po
XENI TOURS	LESHAN	Po
SHUKAJ TOURS	SAMADREXHË	Po
SABA TOURS	NISHOR	Po
ELI TOURS	DOBËRDELAN	Po
PONI	VRANIQ	Po
LENTI	VRANIQ	Po
BENI TOURS	TËRRNJË	Po
GIMI	TËRRNJË	Po
LONI	TËRRNJË	Po
DELTI	STUDENQAN	Po
MAQITEVA	MAQITEVË	Po
SUKA TRANS	BLLACË	Po
BLLACA TRANS	BLLACË	Po
SEDOLLI	PAPAZ	Po
DITI-SONI	STRAVUQINË	Kombi
KOMBI TAXI	SLLAPUZHAN	Kombi

1.2. Ndërrurban: Linja Suharekë – Prizren dhe anasjelltas

Emri i kompanisë-Operatorit	Vendi	Transporti me autobusë
DARDANI	STUDENQAN	Po
XENI	LESHAN	Po
BLEDI	KORRISHË	Po
BESI TOURS	STUDENQAN	Po
ELI	DOBËRDELAN	Po
FATI	SUHAREKË	Po
XENI	TËRRNJË	Po
JETA	SUHAREKË	Po
LENTI	VRANIQ	Po
XENI	TËRRNJË	Po
SHPEJIMI	REQANË	Po
XENI	LESHANË	Po
XHATI	GJINOCË	Po

1.3. Ndërrurban: Linja Suharekë – Malishevë dhe anështetas

Emri i kompanisë-Operatorit	Vendi	Transporti me autobusë
DIDI	BELLANICË	Jo
LINDI	BELLANICË	Jo
BLLACA	SUHAREKË	Jo
SUKA	BLLACË	Jo

1.4. Ndërrurban: Linja Prizren - Suharekë – Prishtinë dhe anështetas

Emri i kompanisë-Operatorit	Vendi	Transporti me autobusë
ARBËRIA		
ATMAXHA		
BASHKIMI		
BRESI		
DIDI		
DRINI		
DARDANI		
ERËZA		
FIDANI		
GASHI		
HALIMAJ		
JETA		
TOSA		
MERKATORI		
MIRI		
SHPEJTIMI		
SHARRI		
SHARR TRAVEL		
VEKTORI		
ZHURI		

12. Rreziqet

12.1. Përshkrimi i rreziqeve që mund të pasojn dhe të krijojnë jo siguri, cilat janë ato natyrale, shtetërore, apo ekonomike:

- Siq është mos zgjidhja e qështjes së pronës(2012) me vite të tëra(2023) dhe për kundër angazhimeve të udhëheqjes së ndërmarrjes me shkresa e kërkesa për Organeve shtetërore të paktën nuk është zgjidhur! ..

12.2. Faktorët e rrezikut që mund të pengojn funksionimin e stacionit në shërbim të pasaxherëve(qytetarëve)dhe operatorëve ekonomik,dhe ofrimin e shërbimit juar.

- Çrregullimi i transportit të mirëfillët rrugorë për udhëtarëve
- Humbja e vendëve të punës të një numri të punëtorëve,tani edhe në muajt
- Ndërrimi i destinacionit-veprimtarisë
- Mos funksionim total me pasoja afatëgjate.

13. Zotimet: Bordi i drejtorëve,Menaxhmenti

Përmbledhja dhe prezantimi i këtij Plan biznesit ka të bëjë me përshkrimin e rreziqeve të cilat do të shfrytëzohen për zhvillimin normal dhe objektiv të N.P.L.,Stacioni i autobusëve"sh.a.

14. Pyetja: A i plotëson nevojat

Stacioni i Autobusave pas një analize të planit zhvillimor afatëmesëm dhe ati e nevojat dhe duke i pa trendin e zhvillimit konkludojm se, nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat mbështetja transportin publik të udhëtarëve në Republikën e Kosovës si e vetmja arterje e transportit tokësor të udhëtimit.

15. Pyetja: Çka duhet të ndërmerret

Stacioni i autobusave i ndërtuar në vitin 1976 për periudhën ka plotësuar kërkesat dhe nevojat e kohës, mirëpo zhvillimi i hovshëm dhe e vetmja mënyrë e udhëtimit tani ka krijuar probleme lokacioni, për të absorbuar levizjen dhe shërbimin e transportit të udhëtarëve.

16. Vështërsit tona: Hapsira ku zhvillohet transporti publik i udhëtarëve ka sipërfaqen 4488m², e cila nuk shfrytëzohet vetëm për transportin e udhëtarëve si: mbi 400m² e shfrytëzojnë disa lokale afarist me leje të përkoshme të objekteve montazhë, të cilat vetëm sa i bëjnë probleme funksionimit normal të veprimtarisë së stacionit kur dihet se çfarë destinimi ka.

Gjithashtu një sipërfaqe prej 600m² mbrapa objektit të Stacionit e destinuar për projektin e ndërtimit të stacionit si sipërfaqe për ndërtimin e kanalit për përdorim të shërbimit të automjetit nën pjesën që ka të bëjë me frenat dhe pjesë tjera teknike, kjo sipërfaqe tani shfrytëzohet për parkingun e automjeteve të punëtorëve të ndërmarrjes.

1. P.S. Shqetësim i N.P.L "Stacioni i autobusave" sh.a, edhe pse me 100% aksionar i vetëm është i KK-Suharekë si Ndërmarrje publike është por edhe më tej nuk është i Licencuar për shkakun se nuk e ka të zgjidhur çështjen e pronës. Ligji Nr.04/L-111 për Ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrje publike ku Stacionet e autobusave dhe shumë ndërmarrje tjera hynë në Ligjin Nr.2 të cilat kalojnë me të gjitha asetet 100% duke përfshirë edhe sipërfaqën prej 4488 m² në kuadër të Komunave përkatëse. Ligji Nr.-4/L-111 i datë: 20 Prill 2012, Dhe sipas Ministrisë së Infrastrukturës, Departamenti i transportit rrugor, përkatësisht Udhëzimit administrativ Nr.08/2013, në Nenin 4 pika 1.1 kërkohet që stacioni si objekt juridik të ketë të rregulluar çështjen e pronës, në të kundërtën nuk u shërbejnë punëtorëve.
2. Këto problem stacionet si motra tani më ka vite që e kanë zgjidhur si problem.

16.1. Propozim: Zgjidhja e problemit:

Eliminimi i objekteve të cilat janë pengesë për zhvillimin e punës normale të stacionit, zgjidhja e lokacionit më periferik dhe ndërtimi i objektit të ri, nga KK-Suharekë si aksionare e Institucione tjera Qeveritare, Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjëra nga Ministrinë (Dikasteret e saja) apo ndonjë donator i mundshëm, për krijimi i hapësirës për levizje të operatorëve dhe pasaxherëve.

Studimi dhe pregatitja e projektit për objektin e ri.

Ndërtimi i objektit me standarde bashkëkohore dhe shfrytëzimi i tërë sipërfaqës për destinacionin e transportit të udhëtarëve.

17. Përfundimi

Ky planifikim mund të mos ketë përfshirë të gjitha detajet të cilat janë kryer dhe të shprehur në të mirë të Ndërmarrjes; Pasaxherëve dhe Operatorëve të transportit të udhëtarëve por ne si menaxhment zotohemi se do të punojmë që detyrat e planifikuara nga ky planifikim buxhetor 2024, do të përmbushen në tërësi në bashkëpunim me Kryeshefin ekzekutiv; Drejtorëve dhe dy Zyrat e Lart të ndërmarrjes.

Suharekë : 26.11.2023



Kryeshi Ekzekutiv
/Mr.sc. [Signature] hani/